



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 26
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 24 tetor 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Enver Hoti, Drita Millaku, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Miljana Nikoliq, Time Kadrijaj, Haxhi Avdyli dhe Fikrim Damka.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit Nr. 04/L -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
3. Vonesa në procedimin e projektligjeve;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Formimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit Nr. 04/L -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale;

Besa Baftiu, kryetare: Në mbledhjen e fundit nuk kemi mundur ta formojmë grupin punues për monitorim, pasi nuk kemi pasur kuorum, andaj ka mbetur që sot si pikë e rendit të ditës, ta formojmë këtë grup. Me planin e punës kemi vendosur ta monitorojmë Ligjin Nr. 04/L -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Propozoj që kryesuesi i grupit punues për monitorim të jetë Bekim Haxhiu ose Naser Rugova. Meqenëse Naser Rugova pranoi që të jetë kryesues i këtij grupi, neve na mbetet që të jemi pjesë e këtij grupi. Sot është dashur ta formojmë edhe grupin

punues për amendamentimin e Projektligjit për Inspektoratin e Punës, por meqenëse ende nuk ka kaluar në Kuvend, pritet që ky grup të formohet në mbledhjen e ardhshme.

Pas diskutimeve, komisioni formoi grupin punues për monitorimin e Ligjit Nr. 04/L -190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale në këtë përbërje: Naser Rugova, kryesues, Besa Baftiu, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj, Fatmire Mulhaxha- Kollçaku dhe Fikrim Damka, anëtarë.

3. Vonesa në procedimin e projektligjeve;

Kryetarja, tha se ka disa vonesa të procedimit të projektligjeve në Kuvend. Sipas strategjisë së Qeveris, kemi hartuar një plan të punës por nuk po mund të punojmë sipas planit sepse nuk kanë ardhur ligjet si janë parapa në strategjinë legjislative.

Po ashtu, dua të diskutojmë edhe për Ligjin për Skemat Pensionale të financuara nga shteti. Më herët, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale ka treguar se është duke bërë një koncept-dokument për një reformë të rëndësishme të sistemit pensional. Propozoj që në mbledhjen e radhës ta ftojme prapë ministrin dhe të shohim deri ku kanë arritur me këtë koncept- dokument, pasi që neni 8 i këtij Ligji, është diskriminues dhe parashih që vetëm ata persona që kanë stazh pune 15 vjet, para vitit 1999, mund ta gëzojnë të drejtën e pensionit.

Nëse ministri nuk është duke punuar në koncept- dokumentin për reformën pensionale, atëherë ne si komision ta marrim iniciativën dhe ta plotësojmë dhe ndryshojmë Ligjin për Skemat Pensionale, sidomos nenin 8, që është mjaft diskriminues.

Haxhi Avdyli, theksoi se nga puna e bërë deri tash kam vërejtur se komisioni ka ngecur me agjendën legjislative dhe shpreh dëshpërimin e thellë që asgjë nuk është punuar këtë vit në reformën shëndetësore, edhe pse kanë qenë të parapara që ligjet të vijnë këtë vit. Ne si deputet e kemi kryer punën tonë në Komision, por ata të cilët është dashur ti procedojnë Projektligjet në Komision nuk i kanë sjellë, prandaj ne duhet të jemi më kërkues dhe të kërkojmë të sillen ligjet e reformës shëndetësore, e të mos punohet vetëm në fasada, ndërsa edhe në sektorin e mirëqenies sociale ka ngecje në procedim të Projektligjeve.

Kryetarja, tha se Ligji për Sigurime Shëndetësore është dashur të sillet në fund të qershorit dhe propozoi që në takimet e radhës, të thirren në takim ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ai i Shëndetësisë, që të shohim se deri ku kanë shkuar me planet dhe punën e tyre.

Ekziston edhe mundësia tjetër, që ne si komision të fillojmë ta draftojmë Projektligjin e pensioneve, të financuar nga shteti.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, tha se mendoj që ne si komision kemi pasur pak punë, por jo për fajin tonë, sepse për aq Ligje sa na kanë ardhur, ne edhe kemi punuar. Sa i përket Ligjit për Sigurime Shëndetësore, vërtetë ky Ligj e ka humb kuptimin, pasi që është diskutuar shumë. Propozoj që t'i thërrasim dy ministrat, atë të shëndetësisë dhe atë të punës. Të flasim për skemën pensionale konkretisht për nenin 8 të ligjit, sepse po paraqitet shumë problematik, ndërsa me ministrin e shëndetësisë të diskutojmë edhe listën esenciale.

Bekim Haxhiu, tha se Ligji për Pajisje dhe Produkte Medicinale, është më se e nevojshme të monitorohet, pasi që Agjencia për Produkte Medicinale ka pasur vështirësi në funksionimin e saj. Ligjin për produkte dhe pajisje medicinale, duhet ta kemi në agjendë vitin e ardhshëm, dhe ta hartojmë një Ligj pa pasur ndikime nga grupet e interesit. Shumica e lëndëve në gjykata për falsifikim të barnave janë parashkruar.

Duhet të fillojmë sa më parë edhe me reformën e skemave pensionale dhe ndryshimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore. Ka ngecje në përmbushjen e strategjisë legjislative e sidomos në procedimin e projektligjeve të reformës në shëndetësi.

Enver Hoti, tha se duhet të jemi më aktivë dhe të kemi përgjegjësi institucionale në mënyrë që t'i realizojmë detyrat tona. Propozoj që të kërkojmë nga ministrat që të na sjellin edhe projektionin buxhetor për ministrinë e tyre, për vitin 2019.

Sa i përket parashkrimit të lëndëve, të falsifikimit të barnave, e them se parashkrimi i lëndëve është shtrati i vdekjes së sistemit të drejtësisë, dhe kjo nuk duhet të ndodhë.

Haxhi Avdyli, tha se po e përmendi edhe një term të rënd, Projektligji për Sigurime Shëndetësore, është duke u bërë për me e dërgua në arkivol, e jo të bëhet masakër në të, siç thash më herët. Jam shumë skeptik që Ligjin për Sigurime Shëndetësore do ta kemi për një kohë të shkurt. Dhe në kohën kur të gjitha gjerat janë digjitalizuar, ne ende mendojmë ti sjellim sigurimet shëndetësore me letër.

Flora Brovina, tha se pajtohem me shumicën e diskutimeve, që u bënë deri më tani, dhe me faktin se të gjithë është dashur të jemi më aktivë në punën dhe përgjegjësitë tona. Sa i përket Ligjit për Skemat Pensionale të financuara nga shteti, mendoj që nuk duhet të diskutohet vetëm neni 8 i këtij Ligji, por duhet diskutohet shumëçka rreth këtij ligji.

Kryetarja, propozoi një vizitë tek ministrinë, me ç' rast dhe të diskutohen këto çështje.

Flora Brovina, tha që kjo nuk ka nevojë të bëhet, pasi ministrat e kanë vendin këtu.

Këto ditë ka qenë shumë aktuale çështja e grave të abuzuara gjatë luftës së fundit në Kosovë, me ç' rast u diskutua shumë rrëfimi para publikut i një gruaje të dhunuar gjatë luftës, e që u tha se është gruaja e parë që foli publikisht. Rasti i saj nuk është i pari që u paraqitë në publik, por kësaj të fundit iu bë shumë marketing. Sepse ka edhe të tjerë, që kanë provuar ta dëshmojnë tash 20 vjet të vërteten, po iu është mbyllur goja.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, tha se rreth këtyre rasteve ne duhet të angazhohemi shumë, në mënyrë që viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, të mos e përjetojnë si dhunim të dyfishtë ngjarjen e tyre.

Kryetarja, tha se do ta diskutojmë edhe këtë çështje me ministrin e Mirëqenies Sociale.

Time Kadrijaj, tha se sa herë që na kanë ardhur ligjet e nuk na kanë pëlqyer, me përkushtim kemi punuar në amendamentimin e ligjeve, në mënyrë që ato ligje të jenë funksionale. Dua ti lus anëtarët e komisionit, që Ligji për Ndërmarrje Sociale, që është në rend dite në Kuvendin e Kosovës, dhe Komisioni për Legjislacion që nuk e ka përkrahur, andaj kërkoj përkrahje nga anëtarët e komisionit në seancë.

Kryetarja, theksoi se ne i kemi diskutuar vërejtjet e Komisionit për Legjislacion dhe kemi ndryshuar fjalën „parti” me „subjekt politik”, dhe e kemi përmirësuar. Ndërsa, për çështjen tjetër, ne prapë në mënyrë unanime e kemi votuar dhe e kemi proceduar në Kuvend, dhe po besoj që në këtë drejtim nuk do të kemi problem.

Time Kadriaj, theksoi se dëshiroj të llobojë, tek anëtarët e komisionit që të bisedojnë edhe me anëtarët e tyre në grupet parlamentare dhe të vijnë dhe ti votojnë ligjet në seancë dhe të mos bojkotojnë.

Drita Millaku, theksoi se unë nuk i përkas fushës së mjekësisë, por nuk hezitohet të jem anëtare në këtë grup. Do të dëshiroja të kem një bashkëpunim me të gjithë juve që keni përvoja. Desha ta di edhe për Ligjin për lehonitë, për gratë lehonitë, se a përfshihet edhe ky te Ligji i Punës.

Kryetarja, tha se Ligji i Pushimit të lehonisë, nuk përfshihet në Ligjin e Punës dhe është një ligj i veçantë. Drafti i projektligjit është në dëgjim publik në Qeveri, pastaj vjen në Kuvend .

Drita Millaku, tha se që është gjendja e keqe në shëndetësi, kjo çështje po shihet dhe nuk donë koment. Çdonjëri që ka punë me QKUK-në apo me cilindo spital rajonal, e vëren që gjendja është e keqe edhe pse po votohen ligjet. Problem më i madh është tek mosrespektimi apo zbatimi. Nuk mund të jemi të gjithë bashkëfajtorë, po ata të cilët i drejtojnë pikërisht këto institucione, përgjegjësia mbetet tek ta.

Në fund Besa Baftiu, kryetare i ftoi për një vizitë në Klinikën e Onkologjisë dhe një drekë pune.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU